

AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“GREEN 17” SH.P.K., DATË 27.06.2023

Sot, në datën 27.06.2023, *Z. Mario Silenti, shtetas italian, lindur ne Itali, me 05.10.1994,*, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit pasaporte YB4968654, në cilësinë e Ortakut Themelues, vendosi themelimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar “GREEN 17” Shpk. Kjo shoqëri do të realizojë veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, Aktin e Themelimit dhe Statutin, i cili i bashkëlidhet këtij Akt – Themelimi, si Shtojca A.

NENI 1 – EMËRTIMI

1.1 Shoqëria emërtohet “GREEN 17” Shpk.

NENI 2 – FORMA

2.1 Shoqëria “GREEN 17” Shpk themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

2.2 Shoqëria vepron në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi.

NENI 3 – SELIA

3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga e Kavajës, Square 21, hyrja 1, kt.4, Njësia Bashkiake nr.7 Tirane, Shqipëri, 1001.

3.2 Shoqëria mund të ketë zyra, degë, zyra përfaqësimi dhe agjenci në adresa të tjera si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.

3.3 Asambleja e Përgjithshme mund të çelë, transferojë dhe/ose mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, degë dhe/ose zyra përfaqësimi dhe/ose njësi vendore të çdo lloji, ndërsa, Administratori i Shoqërisë mund të çelë dhe/ose transferojë dhe/ose mbyllë adresa sekondare të ushtrimit të veprimtarisë, filiale dhe/ose agjenci.

NENI 4 – OBJEKTI

4.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë konsiston ne:

- a) *Tregti me pakicë dhe shumicë e automjeteve të reja dhe te përdorura, import dhe eksport të tyre, tregti të mjeteve motorike, mjete lundruese dhe detare; marrjen e përfaqësive tregtare;*



- b) Dhënie e automjeteve me qira
- c) Investime ne fushën e pasurive te paluajtshme dhe real estate, dhënia e me qira e apartamenteve;
- d) blerje dhe shitje, dhënie me qira trojesh, ndërtesa dhe pasuri te paluajtshme.

NENI 5 – KOHËZGJATJA

- 5.1 Shoqëria themelohet me një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 5.2 Shoqëria mund të priset në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 6 – KAPITALI I SHOQËRISË, KONTRIBUTET DHE KUOTAT


- 6.1. Kapitali i Shoqërisë është është 1'000'000 Lekë (një milion leke), i përbërë nga 1 (një) kuotë e zotëruar nga ortaku themelues Z.Mario Silentí, në masën 100% (njëqind përqind), të kontributit në kapital.
- 6.2 Kuotat e Ortakut/ve të Shoqërisë janë lirisht të transferueshme sipas legjislacionit tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 6.3 Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar dhe zotërohet nga Ortaku Themelues, Z.Mario Silentí, në masën 100% (njëqind përqind), të kontributit në kapital.
- 6.4 Secili nga Ortakët e Shoqërisë përgjigjet për detyrimet kundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të saj.

NENI 7 –TRANSFERIMI I KUOTAVE

- 7.1 Kuotat e Shoqërisë mund të transferohen, tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurës së përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

NENI 8 – ADMINISTRATORI/ËT

- 8.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkërisht, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratori/ët do të qëndrojnë/në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovohet automatikisht edhe për një vit tjetër.
- 8.2 Administratori/ët përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha të drejtat dhe kompetencat e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i




ndryshuar dhe çdo rast në zbatim të kufijve të përcaktuar në aktin e emërimit të tij dhe/ose në Statutin e Shoqërisë.

8.3 Administratori/ët mund të emërojnë përfaqësues me prokurë të posaçme (“ad negotia”) për kryerjen e një veprimi ose disa veprimeve, në kufijtë e tagrave që i/u janë dhënë nga ligji, statuti dhe/ose akti i emërimit.

8.4 Caktohet si Administratori i parë i Shoqërisë:

Znj. Kristina Nikolla, shtetase shqiptare, lindur me 11.04.1999, ne Korçë, madhore dhe me zotësi te plote juridike për te vepruar, mbajtëse e dokumentit te identifikimit/ pasaportës me nr. 033258158, dhe me numër personal J95411017U.

Specimeni i Firmës së Administratorit të Parë të Shoqërisë është si më poshtë:

Emër Mbiemër <i>Kristina Nikolla</i>	Nënshkrimi 
---	--

NENI 9 – GJUHA

9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 2(dy) kopje në gjuhën shqipe.

NENI 10 – DISPOZITA TË FUNDIT

10.1 Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt - Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.

* * *

“GREEN 17 ”sh.p.k.

ORTAKU THEMELUES:

MARIO SILENTI

MARIO SILENTI 